



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

VENDIM

Nr. 557, datë 29.12.2022

**“PËR KRIJIMIN, FUNKSIONIMIN DHE
KOMPETENCAT E KOMISIONEVE TË RISTRUKTURIMIT”
(ndryshuar me vendimin nr. 285, datë 29.05.2023)**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenet 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 90, shkronja “g” të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 66 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 49 dhe 50 të Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe fusha e zbatimit

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e:
 - a) rregullave të detajuara të krijimit dhe funksionimit të Komisioneve të Ristrukturimit që ngrihen në kuadër të riorganizimit të kompetencave tokësore të gjykatave.
 - b) procedurave të verifikimit të kushteve dhe kritereve që duhet të plotësojnë nëpunësit civilë gjyqësorë të konfirmuar në detyrë apo në periudhë prove, si dhe punonjësit e tjerë gjyqësorë, që i nënshtrohen ristrukturimit për shkak riorganizimi, me qëllim transferimin e tyre të përhershëm, në kohën e duhur dhe me efektivitet, në strukturën e gjykatës pritëse.
2. Procedurat e përcaktuara në këtë vendim gjejnë zbatim për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe punonjësit e tjerë gjyqësorë që ushtrojnë detyrën në gjykatat që i nënshtrohen riorganizimit të kompetencave tokësore, sipas vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

KREU II

KRIJIMI, PËRBËRJA DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONEVE TË RISTRUKTURIMIT

Neni 2

Krijimi i Komisionit të Ristrukturimit

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, nxjerr aktin për krijimin e çdo Komisioni Ristrukturimi, jo më vonë se dy ditë pas hyrjes në fuqi të aktit për miratimin e strukturës organizative, nga Këshillat aktualë të Gjykatave pritëse, apo pas hyrjes në fuqi të aktit për miratimin e strukturës organizative, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë¹.
2. Komisionet e Ristrukturimit mbështeten nga Sekretaria Teknike, funksionet e së cilës ushtrohen nga njësia e burimeve njerëzore të gjykatës ku kryhen veprimtarinë Komisioni i Ristrukturimit.
3. Mbledhja e parë e Komisionit të Ristrukturimit thirret nga përfaqësuesi i KLGJ brenda dy ditëve nga krijimi i tyre.

Neni 3

Funksionimi dhe përbërja e Komisioneve të Ristrukturimit

1. Komisionet e Ristrukturimit shqyrtojnë mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil gjyqësor dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të gjykatave që i nënshtrohen riorganizimit, në strukturën dhe organikën e gjykatës pritëse ose të riorganizuar², apo edhe në pozicione të së njëjtës kategori, në gjykata të tjera.
2. Komisioni i Ristrukturimit përbëhet nga kryetarët dhe kancelarët e gjykatave që i nënshtrohen riorganizimit të kompetencave tokësore dhe drejtohet nga një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Në mungesë të kryetarit ose të kancelarit sipas pikës 2 të këtij neni, anëtarë të Komisionit të Ristrukturimit janë zëvendëskryetarët dhe nëpunësit që ushtrojnë detyrat e kancelarit.
4. Komisioni i Ristrukturimit të gjykatave të apelit ushtron funksionet pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe përbëhet nga Kryetarët/Zëvendëskryetarët dhe Kancelarët e gjykatave të apelit Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë dhe Korçë, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
5. Komisionet e Ristrukturimit për riorganizimin e gjykatave të rretheve gjyqësore ushtrojnë funksionet dhe përbëhen:
 - a) Pranë Gjykatës së Rrethit Dibër dhe përbëhet nga Kryetarët/Zëvendëskryetarët dhe Kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Dibër dhe Gjykatës së Rrethit Mat, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
 - b) Pranë Gjykatës së Rrethit Durrës, dhe përbëhet nga Kryetarët dhe Kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Durrës dhe Gjykatës së Rrethit Kavajë, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;

¹ Shtuar me vendimin nr. 285, datë 29.05.2023.

² Shtuar me vendimin nr. 285, datë 29.05.2023.

- c) Pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, dhe përbëhet nga Kryetarët dhe Kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Krujë, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
 - ç) Pranë Gjykatës së Rrethit Fier, dhe përbëhet nga Kryetarët dhe Kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Fier dhe Gjykatës së Rrethit Lushnjë, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
 - d) Pranë Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë, dhe përbëhet nga Kryetarët dhe Kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Gjirokastrë dhe Gjykatës së Rrethit Përmet, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
 - dh) Pranë Gjykatës së Rrethit Lezhë, dhe përbëhet nga Kryetarët dhe Kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Lezhë dhe Gjykatës së Rrethit Kurbin, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
 - e) Pranë Gjykatës së Rrethit Shkodër, dhe përbëhet nga Kryetarët dhe Kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Shkodër dhe Gjykatës së Rrethit Pukë, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
 - ë) Pranë Gjykatës së Rrethit Korçë, dhe përbëhet nga Kryetarët dhe Kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Korçë dhe Gjykatës së Rrethit Pogradec, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
 - f) Pranë Gjykatës së Rrethit Kukës, dhe përbëhet nga Kryetarët dhe Kancelarët respektivë të Gjykatës së Rrethit Kukës dhe Gjykatës së Rrethit Tropojë, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
6. Komisionet e Ristrukturimit për riorganizimin e gjykatave administrative ushtrojnë funksionet dhe përbëhen:
- a) Pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, dhe përbëhet nga Kryetarët dhe Kancelarët respektivë të Gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë, Shkodër, Durrës dhe Korçë, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor;
 - b) Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe përbëhet nga Kryetarët dhe Kancelarët respektivë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe Gjirokastrë, si dhe një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor³.

KREU III

VERIFIKIMI I KRITEREVE DHE NJOFTIMI I VENDIMIT PROPOZUES TË TRANSFERIMIT TË PËRHERSHËM

Neni 4

Njoftimi mbi fillimin e procesit të ristrukturimit

Kancelari i çdo gjykate, menjëherë pas krijimit të Komisionit të Ristrukturimit, njofton individualisht çdo nëpunës të gjykatës për fillimin e procedurës së ristrukturimit.

Neni 5

Vendosja në dispozicion të dokumentacionit Komisioneve të Ristrukturimit

³ Ndryshuar me vendimin nr. 285, datë 29.05.2023.

1. Kancelari i çdo gjykate sipas nenit 4, brenda dy ditëve nga miratimi i vendimit të krijimit të Komisionit të Ristrukturimit përkatës, vendos në dispozicion të tij:
 - a) Përshkrimet e punës së pozicioneve dhe kriteret specifike;
 - b) Kopje të dosjes personale, në format fizik të nëpunësve të gjykatave, në pritje për transferim të përhershëm;
 - c) Vërtetimin e vendbanimit të paraqitur nga nëpunësit.
2. Përfaqësuesi i KLGJ brenda 2 ditëve nga miratimi i vendimit të krijimit të Komisionit të Ristrukturimit përkatës, vendos në dispozicion të tij informacion mbi strukturën dhe organigramën e gjykatës pritëse ose të riorganizuar,⁴ si dhe gjykatave të tjera.

Neni 6

Kushtet dhe kriteret e vlerësimit

1. Çdo Komision Ristrukturimi merr vendim bazuar në vlerësimin e kriterëve si vijon:
 - a) Arsimimi i nëpunësit civil gjyqësor/punonjësve të tjerë;
 - b) Përvoja profesionale në tërësi, përfshi vjetërsinë e shërbimit në sistemin gjyqësor, pozicionin aktual në gjykatë në momentin e riorganizimit, si dhe pozicione të tjera gjatë karrierës profesionale.
2. Çdo Komision Ristrukturimi, brenda 15 ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit për krijimin e tij, përfundon procesin e vlerësimit dhe miraton vendimin propozues për transferimin e përhershëm të të gjithë nëpunësve të gjykatës, bazuar në këto elementë:
 - a) Krahasimin e strukturës së gjykatës pritëse ose të riorganizuar⁵ me strukturën ekzistuese dhe evidenton shërbimet e reja organizative që krijohen, suprimohen apo që ndryshojnë në strukturën e gjykatës pritëse ose të riorganizuar⁶;
 - b) Verifikimin e përshkrimeve të punës;
 - c) Verifikimin e dosjeve personale të nëpunësve civilë gjyqësorë për të evidentuar:
 - (i) përvojën profesionale dhe arsimimin;
 - (ii) largësinë e vendbanimit më shumë së 45 km nga institucioni;
 - ç) dokumentin përkatës të nëpunësit civil gjyqësor me probleme shëndetësore të vërtetuara me raportin përkatës mjekësor.
3. Nëpunësit me probleme shëndetësore të vërtetuara me raport mjekësor, si dhe ata që kanë vendbanimin më shumë se 45 km nga vendi i punës, verifikohen me prioritet nga Komisioni i Ristrukturimit.
4. Në rastet e punonjësve të tjerë të gjykatave, vlerësimi i Komisionit bazohet në përvojën profesionale në tërësi, në sistemin gjyqësor si dhe mundësitë e sistemimit në strukturën dhe organikën e gjykatës pritëse ose të riorganizuar⁷ apo sistemim e tij në një gjykatë tjetër.

Neni 7

Vendimi propozues i Komisionit të Ristrukturimit

⁴ Shtuar me vendimin nr. 285, datë 29.05.2023.

⁵ Shtuar me vendimin nr. 285, datë 29.05.2023.

⁶ Shtuar me vendimin nr. 285, datë 29.05.2023.

⁷ Shtuar me vendimin nr. 285, datë 29.05.2023.

1. Vendimi propozues, për transferimin e përhershëm të nëpunësit civil gjyqësor i dërgohet Këshillit aktual të gjykatës pritëse, kurse për kancelarët vendimi propozues i dërgohet Këshillit të Lartë Gjyqësor.

1.1 Vendimi propozues, për transferimin e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe Vlorë, i dërgohen Njesisë Përgjegjëse pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor⁸.

2. Vendimi propozues identifikon pozicionin në strukturën e gjykatës pritëse ose të riorganizuar⁹, sipas rastit në gjykata të tjera, apo përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil gjyqësor.

3. Çdo vendim i Komisionit të Ristrukturimit, shoqërohet me praktikën mbi bazën e së cilës është marrë vendimi.

4. Vendimet e Komisionit të Ristrukturimit merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, të cilët duhet të jenë të gjithë detyrimisht të pranishëm.

Neni 8

Pranimi ose refuzimi i vendimit propozues

1. Këshilli aktual i gjykatës pritëse, Njësia Përgjegjëse në KLGJ,¹⁰ apo KLGJ, pas marrjes së vendimit propozues të KR sipas pikës 1 dhe 1/1¹¹ të nenit 7, ia njofton atë menjëherë çdo nëpunësi civil gjyqësor dhe punonjësit të gjykatës duke i kërkuar të shprehë me shkrim mendimin për pranimin ose refuzimin e vendimit propozues.

2. Çdo nëpunës civil gjyqësor apo punonjës i gjykatës, ka të drejtë të shprehë me shkrim mendimin për pranimin ose refuzimin e vendimit propozues, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit propozues për transferimin e përhershëm në gjykatën pritëse ose të riorganizuar¹², apo sistemimin në një gjykatë tjetër, në të njëjtën kategori pozicioni.

3. Në rast pranimi të vendimit propozues, Këshilli aktual i gjykatës pritëse, apo sipas rastit Njësia Përgjegjëse pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor¹³ brenda 5 ditëve nga marrja e mendimit me shkrim, njofton me vendim përfundimtar nëpunësin/punonjësin për pozicionin ku transferohet në mënyrë të përhershme.

4. Nëpunësi mund ta refuzojë transferimin vetëm në rastet kur:

- a) gjendja e tij shëndetësore, e provuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur;
- b) gjykata ku i propozohet të transferohet gjendet më shumë se 45 km nga vendbanimi i nëpunësit civil.

5. Refuzimi nga ana e nëpunësit e vendimit propozues të transferimit të përhershëm për arsye të tjera nga ato të përcaktuara në pikën 4, përbën shkak për lirimin nga shërbimi civil gjyqësor.

⁸ Shtuar me vendimin nr. 285, datë 29.05.2023.

⁹ Shtuar me vendimin nr. 285, datë 29.05.2023.

¹⁰ Shtuar me vendimin nr. 285, datë 29.05.2023.

¹¹ Shtuar me vendimin nr. 285, datë 29.05.2023.

¹² Shtuar me vendimin nr. 285, datë 29.05.2023.

¹³ Shtuar me vendimin nr. 285, datë 29.05.2023.

6. Këshilli aktual i gjykatës pritëse, apo Njësia Përgjegjëse pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor,¹⁴ ia ridërgon praktikën Komisionit të Ristrukturimit, i cili brenda 5 ditëve nga njoftimi, rishqyrton shkaqet e refuzimit dhe vendos në lidhje me statusin e nëpunësit.

7. Për punonjësit e tjerë gjyqësorë, zbatohen për aq sa është e mundur, parashikimet e këtij vendimi si dhe dispozitat e Kodit të Punës.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

¹⁴ Shtuar me vendimin nr. 285, datë 29.05.2023.